



Titulli i projektit:

Gjithëpërfshirja sociale në Arsim dhe Aftësim Profesional

Ekspertë: Osman Buleshkaj dhe Georg Neuhauser

Përshkrim i shkurtër i projektit

1. Prapavija e projektit, nevoja:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka synim të ketë shkolla gjithëpërfshirëse sociale, dmth. përfshirjen e të gjithë nxënësve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, kulturore, gjuhësore etj. dhe interesat, aftësitë e ndryshme dhe parakushtet individuale mësimore të nxënësve. Për realizimin e një shkolle për të gjithë duhet të bëhet trajnimi dhe aftësimin i mësimdhënësve, ashtu që të posedojnë metoda të shumta për t'u ballafaquar dhe për të trajtuar heterogjenitetin.

Divizioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional në MASHT propozoj të bëhen aftësime të mësimdhënësve në fushën e gjithëpërfshirjes sociale – „qasje e njëjtë për të gjithë në arsimin profesional“.

Analiza e nevojës e cila është bërë në vitin 2012 në bashkëpunim me MASHT, drejtorët dhe mësimdhënësit e pesë shkollave profesionale paraqiti nevoja të ndryshme në 5 fusha të këtij aspekti. Gjatë këtij hulumtimi në këto pesë shkolla u anketuan mbi 500 nxënës/e, më shumë se 50 mësimdhënës/e si dhe prindër e drejtor të shkollave në dimensione të ndryshme.

Dhe si nevojë e kësaj fushe ,

QAPA, në bashkëpunim me Kultur Kontakt Austria kanë nënshkruar kontratën për projektin

„Gjithëpërfshirja sociale në Arsim dhe Aftësim Profesional“

QAPA, në bashkëpunim me Kultur Kontakt Austria do të vazhdojë programin e trajnimit në në Kosovë me qëllim të zgjerimit të gjithëpërfshirjes sociale në arsim.

Objektivat e projektit

Objektiva parësore

Përkrahja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në zbatimin e gjithëpërfshirjes sociale në arsimin dhe aftësimin profesional – objektivë e arsimit të Kosovës në Planin Strategjik për Arsim të Kosovës 2011-2016

- Objektivat e projektit
 - o Krijimi i një ekipi fleksibil për gjithëpërfshirje në pesë shkollat e projektit, ashtu që të përkrahet individualizimi në të gjitha lëndët mësimore
 - o Zhvillimi i një kulture të shkollës në bazë të Konventës së UNESCO-s për gjithëpërfshirje sociale 1994 – përqëndrim i madh në këtë temë
 - o Përfshirja e mësimdhënësve në një programit trajnimit të akredituar nga Këshilli Shtetëror për Licensim të Mësimdhënësve
 - o Krijimi i „klasëve model“ për të zbatuar metoda të reja të mësimdhënies në shkollat profesionale në Kosovë përmes „Grantit për projekte në shkollë“

Rezultatet e projektit

- Aftësohen afër 20 mësimdhënës nga secila nga 5 shkollat e projektit për gjithëpërfshirje sociale në shkollat e mesme profesionale
- Janë punuar dhe aplikohen materialet për kompetencat themelore gjuhësore (sipas nevojës për lëndët gjuhë shqipe, angleze dhe gjuhë të tjera) si dhe matematikë e informatikë
- 5 shkollat e projektit kanë hartuar me shkrim një rregullore për një qasje dhe kulturë gjithëpërfshirëse të shkollave, e cila përfaqësohet nga drejtori dhe mësimdhënësit e shkollës
- Programi i aftësimit, i akredituar nga nga Këshilli Shtetëror për Licensim të Mësimdhënësve, zbatohet në 5 shkolla tjera në nivel vendi.
- Përmes Granteve për shkollat pjesëmarrëse, janë krijuar „klasët model“ dhe zbatohen me sukses metodat e të nxënimit sipas modelit COOL (Co-Operative and Open Learning - Të nxënimit bashkëpunues dhe i hapur)

2. Grupet e synuara:

a) Grupet e synuar drejtë për drejtë

- Rreth 100 mësimdhënës të shkollave profesionale
- 5 drejtorë të shkollave profesionale

b) Grupet e synuara indirekt

- Nxënësit dhe nxënësit e ardhshëm të pesë shkollave profesionale të Kosovës si dhe prindërit e tyre

3. Aktivitete kryesore

Faza 1: Përgatitja e projekteve dhe rregullimi i klasave (nëntor – dhjetor 2014)

- Vizita në shkolla
- Përgatitja e projekteve
- Aprovimi i projekteve nga Kultur Kontak Austria)
- Realizimi i projekteve

Faza 2: Trajnimi i trajnerëve (java e tretë në dhjetor 2014)

- Datat 19 – 21 dhjetor
- Pjesëmarrës 6 trajnerë vendor nga shkollat profesionale
- Trajnerët e Trajnerëve: Georg Neuhauser dhe Osman Buleshkaj
- Përgatitja e paketit të materialeve për mësimdhënësit e shkollave pjesëmarrëse

Faza 3: Trajnimet e mësimdhënësve nga shkollat pjesëmarrëse

- Gjatë periudhës janar – prill 2014
- 3 seminare nga 2 ditë pune
- 1 takim reflektues/mentorues në shkolla
- Ceremonia përmbyllëse dhe certifikimi i pjesëmarrësve

